



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Pritmjen/Prodato Received / Delivery	20.07	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	5317/2023	Shtet / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
			1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.822/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.822/2023 të datës 07.06.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Komunës së Fushë Kosovës, në çështjen juridike "shkelje e se drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.07.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.822/2023 e datës 07.06.2023, e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Nëpunësja civile (tutje ankuesja) e punësuar në Komunën e Fushë Kosovës, më datë 07.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.822/2023, për njohje të se drejtë se kompensimit të diferencës së pagës nga koeficient (7) në tetë (8) për periudhën nga data 01.07.2016 e deri me datën e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe rregullimin e gradës sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nga koeficienti 4.90 në 5.62 dhe kompensimin e diferencës së pagës nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 12.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Fushë Kosovës. Ndërsa, Këshilli me datë 14.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4623/2023 të datës 07.06.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën nr.159 të datës 23.02.2023 të parashtruar nga ankuesja tek Drejtoria e Administratës në Komunën e Fushë Kosovës; Përgjigjen në ankesë të ankueses përmes e-mailit të datës 07.03.2023; Akt emërimit nr.773 të datës 11.07.2016; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtare

e Lartë e Prokurimit të datës 09.03.2023; Certifikatën profesionale për prokurim e datës 23.01.2010; Certifikatën profesionale për prokurim e datës 24.12.2009; Certifikatën e datës 27.12.2006; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.06.2023; Përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit të datës 14.06.2023; Lista e pagave për muajin janar 2023 dhe Lista e pagave për muajin shkurt 2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Komunën e Fushë Kosovës dhe se e njëjta sipas Akt Emërimit me numër protokolli 773 të datës 11.07.2016, është emëruar Zyrtare e Lartë e Prokurimit në Zyrën e Prokurimit. E njëjta më datë 23.02.2023 ka parashtruar ankesë pranë Drejtorisë për Administratë të Komunës së Fushë Kosovës, me bazën që t'i kompensohet diferenca e pagës nga koeficienti shtatë(7) në koeficientin tetë (8) për periudhën nga 01.07.2016 e tutje si dhe rregullim të koeficientit të pagës sipas ligjit të ri të pagave Nr.08/L-196 nga koeficienti 4.9 në 5.62. Drejtoria e Administratës në përgjigje të ankesës se ankueses ka njoftuar të njëjtin së bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, ankesa duhet të parashtrohen drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga, Komuna e Fushë Kosovës, ka përcjell të gjitha dokumentacionin që pagat të paguhen në pajtim me këtë ligj.

Ankuesja me datë 07.06.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për njohje të së drejtës së kompensimit të diferencës së pagës nga koeficienti shtatë (7) në tetë (8) për periudhën nga data 01.07.2016 deri me datën e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe rregullimin e gradës sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nga koeficienti 4.90 në 5.62 dhe kompensimin e diferencës së pagës nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankueses lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficiente nga shtatë (7) në tetë (8) për periudhën nga data 01.07.2016 deri me datën e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankueses si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedhë së ankuesja me datë 01.07.2016 ka nënshkruar pa vërejtje Aktin e emërimit për pozitën Zyrtare e Lartë e Prokurimit me koeficient të pagës shtatë (7), dhe se e njëjta edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës deri me datë 23.02.2023 ( data e parashtrimit të kërkesës të organi punësimit) nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative përkatësisht nenin 130 pika 1 dhe 2 të këtij ligji ku përcaktohej se: *"Ankimimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin..."* andaj, mbi këtë bazë rrjedhë së pretendimi i ankueses për kompensimin në mënyrë retroaktive është i pabazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses për rregullim të koeficientit sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e këtij ligji i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *"1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj"*, dhe nenin 14 paragrafi 3 të të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e*

përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Fushë Kosovës, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankueses lidhur me kategorizimin e pozitës është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritor, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankueses i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së saj të punës.


Duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*


## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.822 /2023

Avdyll BEKTESHI

  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

